

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6687  
E mërkurë, 24 gusht 2022  
çmimi 0.40

## Komunat dorëzuan paditë kundër MASHTI-t dhe MSh-së



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

I DËRGUARI I POSAÇËM I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS PËR BALLKANIN  
PERËNDIMOR, GABRIEL ESCOBAR, VJEN PËR VIZITË NË KOSOVË

## ESCOBARI VJEN NË KOSOVË PËR DIALOGUN DHE SITUATËN E FUNDIT NË VERI

FAQE 4-5



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të martën në takim të dërguarin e posaçëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar. Temë diskutimi mes Osmanit dhe Escobarit ishin dialogu Kosovë-Seribi dhe situata në veri. Presidentja Osmani ka potencuar se Kosova do të vazhdojë të jetë palë

konstruktive, e barabartë dhe e përkushtuar në procesin e dialogut, duke kontribuar për paqe dhe stabilitet në vend dhe rajon. Osmani ka theksuar se prioritet i institucioneve të Kosovës është zbatimi i ligjit dhe në këtë kontekst ka potencuar se vendimet e institucioneve të Kosovës janë në përputhje me marrëveshjet e Brukselit

### AKTUALE



**BORRELLI: SHUMICA E VENDEVE  
PAJTOHEN ME DRAFTIN E BE-SË PËR  
MARRËVESHJEN BËRTHAMORE** F. 2

**S'MERREN PARASYSH ANKESAT E  
AVOKATËVE TË LIDERËVE TË UÇK-SË  
PËR MANGËSITË E PRETENDUARA NË  
AKTAKUZË** F. 5

**KRIZË PËR PELET** F. 6

### EKONOMI



**KRASNIQI: QEVERIA KA BLOKUAR  
NË TËRËSI INVESTIMET PUBLIKE  
KAPITALE** F. 8

**LDK-JA PROPOZON DHJETË PIKA  
PËR TA PËRBALLUAR KRIZËN E  
ENERGJISË ELEKTRIKE** F. 8

### SPORT



**DAJA PAS FITORES NDAJ SHKUPIT:  
JA ÇFARË PRES NË NDESHJEN E DYTË** F. 8




## KËRKOHEM RITJE E TRANSPARENCËS NË DIALOGUN KOSOVË - SERBI

FAQE 4

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar analizën "Dialogu Kosovë - Serbi", e cila fokusohet në tri aspektet e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, në nevojën për përparim drejt marrëveshjes finale, në nevojën për zhvillimin e dialogut të brendshëm me komunitetin serb në Kosovë, si dhe në nevojën për rritje të

transparencës dhe llogaridhënies së qeverisë ndaj Kuvendit dhe publikut të gjerë lidhur me këtë proces. Violeta Haxholli nga KDI-ja ka theksuar se vazhdimi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë mbetet faktor i rëndësishëm për politikën e jashtme të Kosovës në veçanti, por edhe për stabilitetin në rajon në përgjithësi



**JASHARAJ, NAGAVCI:  
GREVA NUK ËSHTË KËRCËNIM,  
NIS MË 25 GUSHT** F. 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Dita e Pavarësisë, ShBA-ja: Rusia planifikon sulme në Ukrainë

UASHINGTON, 23 GUSHT - Ukraina ka bërë me dije se Rusia ka bombarduar rajonin e Zaporizhjas, shtëpia e centralit më të madh bërthamor në Evropë, ku luftimet e fundit kanë shkaktuar frikë për një incident katastrofik bërthamor, pasi Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë paralajmëruar se Moska po planifikon sulme në infrastrukturë dhe objekte qeveritare, që përkohë me Ditën e Pavarësisë së Ukrainës.

Dita e Pavarësisë së Ukrainës është më 24 gusht. Sot (e mërkurë) bëhen gjashtë muaj prej kur nisi pushtimi i paprovokuar rus, pra më 24 shkurt.

Shtabi i Përgjithshëm i Ukrainës ka thënë më 23 gusht se forcat ruse vazhduan të lëshonin raketa dhe predha artilerie në qytetet ukrainase, duke goditur vendbanimet Nikopol, Kriviy Rih dhe Synelnykovsky, të gjitha afër uzinës bërthamore të Zaporizhjas.

Gubernatori rajonal Valentyn Reznichenko ka shkruar në

llogarinë e vet në "Telegram" se të paktën katër persona u plagosën në sulmet që ndodhën gjatë natës. Në deklarata të ndara, Ambasada e ShBA-së në Kiev dhe një zyrtar amerikan kanë paralajmëruar për planet ruse për ta goditur infrastrukturën civile dhe qeveritare ditët në vijim.

Një zyrtar amerikan ka paralajmëruar se Rusia është duke planifikuar të nisë së shpejti sulme të reja kundër infrastrukturës civile dhe objekteve qeveritare të Ukrainës, pasi Kiev ka ndaluar festimet publike të Ditës së Pavarësisë këtë javë, duke përmendur një kërcënim të shtuar të sulmeve nga Moska. "Ne kemi informacione se Rusia po shton përpjekjet për t'i nisur sulmet kundër infrastrukturës civile dhe objekteve qeveritare të Ukrainës në ditët në vijim. Duke pasur parasysh historikun e Rusisë në Ukrainë, ne jemi të shqetësuar për kërcënimin e vazhdueshëm që sulmet ruse paraqesin për civilët dhe infrastrukturën civile",



Edhe shërbimi inteligjent i citohet të ketë thënë zyrtari i pidentifikuar për "Reuters". Paralajmërimi i tij është bërë pasi autoritetet ukrainase kanë ndaluar festimet publike në kryeqytetin ukrainas, Kiev, në shënimin e 31-vjetorit të pavarësisë nga sundimi sovjetik, duke përmendur një kërcënim të shtuar nga sulmet. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka thënë se Rusia këtë javë mund të bëjë "diçka shumë të keqe, diçka shumë mizore".

Ukrainës ka paralajmëruar për një rritje të mundshme të sulmeve të hakerëve në faqet ukrainase më 24 gusht.

Luftimet pranë Zaporizhjas kanë shkaktuar frikë për një aksident bërthamor.

Rusia ka kërkuar që Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara të mbajë mbledhje më 23 gusht për situatën në centralin bërthamor të Zaporizhjas. Kështu ka thënë zëvendësambasadori rus në OKB, Dmitry Polyanskiy, sipas agjencisë shtetërore të

lajmeve ruse, "RIA".

Pothuajse 9 mijë pjesëtarë të ushtrisë ukrainase janë vrarë gjatë luftës kundër Rusisë, tha më 22 gusht shefi i forcave të armatosura të Ukrainës. Këto janë shifra të prezantuara nga gjenerali ukrainas Valeriy Zaluzhnyi.

Të dyja palët në luftë kanë qenë jashtëzakonisht të kujdesshme për zbulimin e ndonjë shifre të viktimave që kur Rusia pushtoi Ukrainën më 24 shkurt.

Herën e fundit që zyrtarët ukrainas njoftuan humbje në forcat e armatosura ishte në prill, kur presidenti Volodymyr Zelensky ka thënë se deri në 3 000 ushtarë ukrainas ishin vrarë dhe 10 mijë janë plagosur.

Moska, ndërkohë, i klasifikon vdekjet ushtarake si sekrete shtetërore dhe rrallë herë ka përditësuar shifrat e saj zyrtare të viktimave. Më 25 mars, hera e fundit që është dhënë shifra zyrtare, është thënë se 1 351 ushtarë rusë ishin vrarë.

Zyrtarët ukrainas kanë vlerësuar humbjet ruse në rreth 45 500 trupa.

## Borrelli: Shumica e vendeve pajtohen me draftin e BE-së për marrëveshjen bërthamore

BRUKSEL, 23 GUSHT - Kryediplomati i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, ka bërë me dije se shumica e vendeve që janë pjesë e diskutimeve me Iranin për ringjalljen e marrëveshjes bërthamore të vitit 2015 janë dakord me propozimin e fundit të bllokut, ndërsa të gjitha palët po presin përgjigjen e Uashingtonit, pasi Teherani dha opinionin e tij për draftin final. "Shumica e tyre (vendeve) pajtohen, por unë ende nuk e kam përgjigjen nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilët i kuptoj se duhet ta diskutojnë atë, dhe ne presim që gjatë kësaj jave të marrim një përgjigje", ka thënë Borrelli në një intervistë për transmetuesin kombëtar spanjoll "TVE".

BE-ja ka theksuar më 9 gusht se

drafti prej 25-faqesh u është dorëzuar kryeqyteteve të përfshira në proces dhe se teksti është përfundimtar.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë mohuar akuzat e Iranit për "zvarritjen" e negociatave që synojnë ringjalljen e marrëveshjes bërthamore, duke thënë se Uashingtoni po punon sa më shpejt që është e mundur për të kthyer përgjigje të përshtatshme ndaj komenteve të Teheranit në draftin final të marrëveshjes të paraqitur nga Bashkimi Evropian.

Zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, Ned Price, ka thënë më 22 gusht se ShBA-ja ishte e inkurajuar nga Irani që duket se ka hequr dorë nga disa nga kërkesat, siç është ajo për heqjen e përcaktimit të terrorizmit për



Korpusin e Gardës Revolucionare të Iranit (IRGC), por shtoi se ka ende çështje të pazgjidhura që duhet të zgjidhen.

Price ka folur disa orë pasi Irani pretendoi se Uashingtoni ishte

duke "zvarritur" negociatat jodirekte për ta ringjallur marrëveshjen bërthamore dhe se këmbimi i të burgosurve me Shtetet e Bashkuara nuk është i lidhur me bisedimet bërthamore, raporton "Rel".

Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme të Iranit, Nasser Kanaani, ka thënë në një konferencë për medie më 22 gusht në Teheran se, shumë pak çështje kanë mbetur për t'u diskutuar, por të gjitha janë shumë të rëndësishme. Ai ka thënë se Irani i duhet marrëveshje e qëndrueshme që do t'ia ruante të drejtat legjitime. "Amerikanët janë duke e zvarritur procesin dhe pala evropiane nuk është duke vepruar... Amerika dhe Evropa kanë nevojë për marrëveshje më

shumë sesa Irani", ka thënë ai. Irani ka nënshkruar marrëveshjen bërthamore me Shtetet e Bashkuara, Francën, Gjermaninë, Britaninë, Rusinë dhe Kinën më 2015.

Marrëveshja parasheh që Irani ta kufizojë aktivitetin bërthamor në këmbim të heqjes së sanksioneve ndërkombëtare.

Më 2018 Uashingtoni është tërhequr nga marrëveshja dhe ka rikthyer sanksionet ndaj Teheranit. Prej asaj kohe Irani ka nisur t'i shmanget marrëveshjes dhe ta rrisë pasurimin e uraniumit.

Negociatorët nga Irani, Rusia dhe Bashkimi Evropian – si dhe nga Shtetet e Bashkuara, indirekt – kanë rinisur bisedimet për marrëveshjen me Teheranin më 4 gusht në Vjenë, pas disa muajsh bllokada në negociata.

## Gjermania refuzon propozimin për furnizimin e Ukrainës me armatim shtesë

BERLIN, 23 GUSHT - Ministria gjermane e Mbrojtjes ka hedhur poshtë propozimin e deputetëve të Bundestagut nga koalicioni qeverisës për ta furnizuar Ukrainën me më shumë armatim dhe nëse është e nevojshme, për të rënë dakord për t'i dobësuar forcat e armatosura gjermane për shkak të kërcënimit që vjen aktualisht nga Federata Ruse, shkruan "Deutsche Welle".

Përfaqësuesi zyrtar i

departamentit ushtarak ka thënë se në situatën aktuale, Gjermania nuk mund të marrë rreziqe të tilla. "Ne duhet të jemi të përgatitur për faktin se Putini do të përfitojë nga çdo dobësi dhe hendek i përkohshëm në gatishmërinë mbrojtëse të NATO-s", e ka cituar atë agjencia e lajmeve "AFP".

Ai ka kujtuar se Gjermania duhet t'u japë partnerëve të saj të aleancës "mbështetje brenda kornizës së detyrimeve", siç

përcaktohet në nenin 5 të Traktatit të NATO-s.

Në të njëjtën kohë, në një artikull të përbashkët për "Der Spiegel", të botuar më 21 gusht, socialdemokrati Kristian Klinck, përfaqësuesi i Partisë së Gjelbër Unioni 90 dhe demokrati Alexander Myller, kanë kritikuar qëndrimin aktual të Berlinit, i cili ka thënë se ruajtja e potencialit të Bundeswehrit për ta mbrojtur Gjermaninë dhe NATO-n ka

përparësi ndaj ofrimit të ndihmës për Ukrainën.

Autorët e artikullit kanë theksuar se deri më tani qeveria shpjegonte sasitë relativisht të vogla të ndihmës ushtarake për Ukrainën me mungesën e pajisjeve ushtarake në vetë ushtrinë gjermane.

"Kjo nuk është gjë tjetër veçse një konflikt i ndërtuar qëllimshëm, pasi siguria dhe stabiliteti i Evropës aktualisht po mbrohen në



Ukrainë", kanë thënë ata. Sot (e mërkurë) bëhen gjashtë muaj prej kur nisi pushtimi i paprovokuar rus i Ukrainës më 24 shkurt.

I DËRGUARI I POSAÇËM I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS PËR BALLKANIN PERËNDIMOR, GABRIEL ESCOBAR, VJEN PËR VIZITË NË KOSOVË

## Escobari vjen në Kosovë për dialogun dhe situatën e fundit në veri

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të martën në takim të dërguarin e posaçëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar. Temë diskutimi mes Osmanit dhe Escobarit ishin dialogu Kosovë-Seribi dhe situata në veri. Presidentja Osmani ka potencuar se Kosova do të vazhdojë të jetë palë konstruktive, e barabartë dhe e përkushtuar në procesin e dialogut, duke kontribuar për paqe dhe stabilitet në vend dhe rajon. Osmani ka theksuar se prioritet i institucioneve të Kosovës është zbatimi i ligjit dhe në këtë kontekst ka potencuar se vendimet e institucioneve të Kosovës janë në përputhje me marrëveshjet e Brukselit

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 GUSHT- Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të martën në takim të dërguarin e posaçëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar.

Presidenca ka njoftuar se në takim me Escobarin, presidentja Osmani diskutoi për procesin e dialogut me Serbinë, si dhe zhvillimet e fundit, me theks të veçantë në veriun e Kosovës. "Presidentja ka potencuar se Kosova do të vazhdojë të jetë palë konstruktive, e barabartë dhe e përkushtuar në procesin e dialogut, duke kontribuar për paqe dhe stabilitet në vend dhe rajon. Presidentja Osmani ka theksuar se prioritet i institucioneve të Kosovës është zbatimi i ligjit dhe në këtë kontekst ka potencuar se vendimet e institucioneve të Kosovës janë në përputhje me

marrëveshjet e Brukselit për lirinë e lëvizjes dhe nuk drejtohet kundrejt asnjë komuniteti", ka njoftuar Presidenca e Kosovës.

Sipas presidentes Osmani, institucionet e Kosovës janë në komunikim dhe koordinim të vazhdueshëm me partnerët tanë ndërkombëtar dhe çdo vendim i tyre reflekton frymën kushtetuese të vendit dhe vlerat demokratike. Escobar po qëndron në Prishtinë pesë ditë pas rundit të fundit të dialogut midis Kosovës dhe Serbisë, që u mbajt në Bruksel me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian.

Në këtë takim, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, nuk arritën ndonjë marrëveshje.

Takimi u thirr me synim uljen e tensioneve, pasi serbët lokalë në fund të korrikut dhe fillim të gushtit, kundërshtuan dy vendime të Qeverisë së Kosovës për targat dhe dokumentet serbe.

Escobar atë ditë u raportua se ishte



brenda ndërtesës ku u mbajtën takimet, por SHBA-ja nuk është e përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejt në dialog, por mbështet BE-në në këtë proces. Gjatë javës, në Prishtinë dhe Beograd do të qëndrojë edhe i dërguari i BE-së për dialogun Kosovë-Serbi, Miroslav Lajçak. BE-ja ka thënë se palët janë pajtuar që të vazhdojnë dialogun për të gjetur një zgjidhje për targat dhe dokumentet serbe para 1 gushtit.

Pas heqjes së barrikadave pasditën e 1 gushtit, Qeveria e Kosovës u zotua që do të shtyjë zbatimin e vendimeve për 1 shtator.

Vendimi i parë ka të bëjë me reregjistrimin e makinave që kanë

targa të lëshuara nga Serbia, në ato RKS (Republika e Kosovës). Targat me akronime të qyteteve të Kosovës – sikurse KM, PZ e të ngjashme – që lëshohen nga Serbia, konsiderohen ilegale nga Prishtina zyrtare.

Ndërkaq, vendimi i dytë ka të bëjë me lëshimin e një dokumenti për hyrje-dalje për të gjithë shtetasit e Serbisë, që hyjnë në Kosovë. Këtë dokument, Serbia ua lëshon shtetasve të Kosovës që 11 vjet dhe derivon nga Marrëveshja për lirinë e lëvizjes që palët kanë arritur në Bruksel më 2011.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë se shteti i tij me dëshpërim po kërkon që të gjendet një zgjidhje para 1

shtatorit, teksa më 21 gusht ka deklaruar se të gjitha propozimet e tij janë refuzuar nga Kurti gjatë rundit të 18 gushtit.

Ndërkaq, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti më herët ka thënë se vendimet e Qeverisë për targat dhe dokumentet janë ligjore dhe se Kosova është e gatshme të heqë dorë nga vendimi për lëshimin e dokumentit për hyrje/dalje, nëse edhe Serbia bën të njëjtën gjë.


Escobar në rezidencën e ambasadorit amerikan në Prishtinë ka zhvilluar takime me kryetarin e PDK-së, Memli Krasniqi, kryetarin e LDK-së, Lumir Abdixhiku dhe kryetarin e AAK-së, Ramush Haradinaj.

## KOMF: Mohimi i arsimit, shkelje e të drejtës themelore të fëmijës

PRISHTINË, 23 GUSHT - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF), i cili përfaqëson 34 organizata joqeveritare, shpreh shqetësim për paralajmërimin e ndërprerjes së mësimin në tërë sistemin arsimor në Kosovë si pasojë e grevës. "Mohimi i arsimit është shkelje e të drejtës themelore të fëmijës, e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës. Pa kontestuar arsyet apo qëllimet e grevës, konsiderojmë se këto ndërprerje të përsëritura të procesit të rregullt mësimor ndër vite janë në kundërshtim me të drejtën themelore të fëmijës në arsim dhe në kundërshtim me interesin më të mirë të fëmijëve", ka theksuar KOMF duke shtuar se e njeh të drejtën e grevës si e drejtë e garantuar me legjislacion, por konsideron se ndërprerjet e

vazhdueshme të procesit arsimor kanë dëmtonuar dhe po dëmtojnë procesin e rregullt mësimor dhe mësimnxënien e fëmijëve.

KOMF ka theksuar se vonesat në procesin mësimor do të lënë pasoja domethënëse në zhvillimin e fëmijëve dhe do ta zbehin autoritetin e shkollës si institucion i dijes. "Situata e arsimit në Kosovë është rënduar ndjeshëm vitet e fundit, për pasojë KOMF konsideron se ndërprerja e procesit mësimor do ta përkeqësojë edhe më tej gjendjen e fëmijëve. KOMF u bën thirrje të gjitha palëve në këtë proces të gjejnë një zgjidhje të përbashkët dhe të krijojnë arsimim të qëndrueshëm në Kosovë në mënyrë që në të ardhmen të mos ketë humbje të mësimin dhe nxënësit ta vijojnë mësimin pa ndërprerje", ka njoftuar KOMF.





INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS (KDI) KA PUBLIKUAR ANALIZËN "DIALOGU KOSOVË - SERBI"

## Kërkohet rritje e transparencës në dialogun Kosovë - Serbi

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar analizën "Dialogu Kosovë - Serbi", e cila fokusohet në tri aspektet e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, nevojën për përparim drejt marrëveshjes finale, nevojën për zhvillimin e dialogut të brendshëm me komunitetin serb në Kosovë, si dhe nevojën për rritje të transparencës dhe llogaridhënies së qeverisë ndaj Kuvendit dhe publikut të gjerë lidhur me këtë proces. Violeta Haxholli nga KDI-ja ka theksuar se vazhdimi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë mbetet faktor i rëndësishëm për politikën e jashtme të Kosovës në veçanti, por edhe për stabilitetin në rajon në përgjithësi

**EPOKA  
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 23 GUSHT - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur të martën një konferencë për medie lidhur me dialogun Kosovë - Serbi, në të cilën ka shpalosur një analizë të shkurtër lidhur me këtë çështje

me titullin "Dialogu Kosovë - Serbi: një hap para, tre hapa mbrapa".

Kjo analizë fokusohet në tri aspektet e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, në nevojën për përparim drejt marrëveshjes finale, në nevojën për zhvillimin e dialogut të brendshëm me komunitetin serb në Kosovë, si

dhe në nevojën për rritje të transparencës dhe llogaridhënies së qeverisë ndaj Kuvendit dhe publikut të gjerë lidhur me këtë proces.

Me këtë rast, Violeta Haxholli nga KDI-ja ka theksuar se vazhdimi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë mbetet faktor i rëndësishëm për politikën e jashtme të Kosovës në veçanti, por edhe për stabilitetin në rajon në përgjithësi.

Ajo shtoi se Kosova dhe Serbia, ndonëse për më tepër se një dekadë po negociojnë nën platformën e BE-së, ideja e bisedimeve dhe epilogut final mbetet akoma e paqartë. "Me gjithë marrëveshjet e shumta përgjatë gjysmës së parë të procesit, dialogu ka prodhuar paqartësi, ndërsa dy vendet ende nuk kanë arritur një marrëveshje finale. Diskutimet në kuadër të dialogut janë zhvilluar kryesisht për tema teknike, për të cilat është

diskutuar e ridiskutuar varësisht nga zhvillimet në terren", ka thënë ajo.

Haxholli theksoi se, që kur kanë rifilluar takimet e dialogut në Bruksel pas zgjedhjes së Qeverisë së re në Kosovë, mbi më shumë se një vit temat të cilat janë diskutuar kanë qenë liria e lëvizjes, konkretisht çështja e tabelave të veturave, energjia dhe çështja e personave të pagjetur. Sipas saj, pas shumë përpjekjeve palët janë pajtuar për një udhërrëfyes për zbatimin e marrëveshjes për energji, ndërsa ende nuk ka marrëveshje për lirinë e lëvizjes dhe personat e pagjetur.

Më tutje theksohet se, në anën tjetër, edhe dakordimin e ri për udhërrëfyesin për energji duket se do ta përcjellë e njëjta praktikë e moszbatimit, pasi që Serbia nuk i ka zbatuar pikat e udhërrëfyesit sipas afateve të përcaktuara. Kjo situatë do t'i detyrojë palët të diskutojnë sërish për këtë çështje.

Në ndërkohë mbeten shumë tema për të cilat ende duhet të arrihen pajtime mes palëve, ndërsa duhet të diskutohet edhe mbi marrëveshje të cilat janë arritur shumë moti, por që nuk janë zbatuar në praktikë siç është, p.sh., marrëveshja e diplomave, IBM-i etj.

Haxholli tha se tani takimet e dialogut po mbahen vetëm si reaksion ndaj zhvillimeve në terren siç ishte takimi i 18 gushtit pas vendimit të qeverisë lidhur me marrëveshjen për lirinë e lëvizjes. Ndërsa nuk duket se ka vullnet politik të palëve për të lëvizur përpara drejt marrëveshjes finale edhe pse kjo mbetet kërkesë dhe kriter i Bashkimit Evropian për të dy vendet për të lëvizur përpara drejt proceseve integruese.

Sipas analizës së KDI-së, palët duhet t'i rifillojnë sa më parë diskutimet mbi elementët e kësaj marrëveshjeje në mënyrë që të përafrohen te zgjidhja përfundimtare, e cila pastaj do të

# S'merren parasysht ankesat e avokatëve të liderëve të UÇK-së për mangësitë e pretenduara në aktakuzë

HAGË, 23 GUSHT - Paneli i Gjykatës së Apelit ka hedhur poshtë tri apelet e dorëzuara nga mbrojtja e Hashim Thaçit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit në lidhje me mangësitë e pretenduara në aktakuzë. Ky njoftim është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës Speciale. "Më 22 gusht 2022, Paneli i Gjykatës së Apelit hodhi poshtë tri apele, të dorëzuara nga Thaçi, Selimi dhe Krasniqi, kundër vendimit të mëparshëm të gjykatësit të procedurës paraprake, në të cilin u hodhën poshtë disa nga mocionet e mëparshme të mbrojtjes dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) u urdhërua

ta dorëzojë versionin e korigjuar të aktakuzës së konfirmuar", është thënë në njoftim.

Ndryshe, më 29 prill, Zyra e Prokurorit të Specializuar ka dorëzuar një aktakuzë të ndryshuar ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit.

Prokuroria është duke pretenduar se katër të akuzuarit kanë kryer krime lufte edhe në Gjilan, Budakovë e Semetishtë. Në aneksin e publikuar sa iu përket krimeve që pretendohen se ndodhën në Semetishtë dhe Budakovë, prokuroria ka listuar krimet e luftës si arrestimi dhe ndalimi i paligjshëm ose arbitrar,

trajtim mizor ose çnjerëzor, torturë, vrasje. Ndërkaq, si krime kundër njerëzimit i ka listuar burgimin, vepra të tjera çnjerëzore, torturën, vrasjen, zhdukjen e personave me forcë dhe persekutimin.

Kurse për krimet që pretendon që ndodhën në Gjilan, si krime lufte i ka listuar arrestimin dhe ndalimin e paligjshëm ose arbitrar, trajtimin mizor ose çnjerëzor, torturën dhe vrasjen. Ndërsa si krime kundër njerëzimit i ka listuar burgimin, vepra të tjera çnjerëzore, torturën, vrasjen dhe persekutimin.

Më 9 nëntor të vitit 2020, në

paraqitjet e tyre të para, Jakup Krasniqi e Hashim Thaçi janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që u vihen në barrë.

Njëjtë është deklaruar edhe Kadri Veseli në paraqitjen e tij më 10 nëntor, sikurse edhe Rexhep Selimi më 11 nëntor të vitit 2020. Aktakuza ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është konfirmuar më 26 tetor 2020. Sipas akuzës, së paku midis marsit 1998 deri në shtator 1999, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi dhe anëtarë të tjerë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët kishin qëllimin e

përbashkët për të siguruar dhe ushtruar kontroll mbi të gjithë Kosovën përmes metodave që përfshinin frikësimin, keqtrajtimin, ushtrimin e dhunës dhe eliminimin e paligjshëm të atyre që konsideroheshin si kundërshtarë.

Të gjitha këto akuza janë kundërshtuar nga liderët e UÇK-së.

Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi janë duke u mbajtur në paraburgim në Hagë që nga nëntori i vitit 2020. Përpos tyre, në paraburgim janë duke u mbajtur edhe Sali Mustafa, Hysni Gucati, Nasim Haradinaj dhe Pjetër Shala.



kishte efekt domino edhe në zgjidhjen e çështjeve teknike. Po ashtu, theksohet se, në të kundërtën, mungesa e vullnetit politik për të ecur përpara drejt marrëveshjes finale, do të vazhdojë të reflektojë në situatën në terren, duke mbajtur një status quo të paqëndrueshme që prodhon herë pas here tensione. Paralelisht me vazhdimin e procesit të dialogut, Haxholli

shtoi se qeveria duhet ta zbatojë në praktikë idenë e kamotshme për një dialog të brendshëm me komunitetin serb që jeton në Kosovë "me qëllim të rritjes së komunikimit dhe bashkëpunimit mes institucioneve të Kosovës dhe këtij komuniteti, me synim garantimin e integritetit të qëndrueshëm në shtetin e Kosovës. Lidhur me vendimet e

qeverisë që prekin qytetarët e këtij komuniteti, qeveria duhet të organizojë kampanja sistematike të informimit në terren që shkojnë përtej postimeve në rrjetet sociale. Në këtë drejtim duhet të ketë bashkëpunim me komunat serbe për shpërndarjen e informacioneve të ky komunitet", ka pohuar Haxholli. Sa i përket transparencës dhe

llogaridhënies së procesit të dialogut, Haxholli theksoi se qeveria duhet t'i rrisë transparencën dhe llogaridhënien e procesit të dialogut ndaj Kuvendit dhe publikut duke rritur numrin e raportimeve në Kuvend me vetinciativë dhe duke lehtësuar qasjen në informatat rreth dialogut për publikun në uebfaqen zyrtare. "Në këtë

drejtim duhet të ketë raportim sistematik të përfaqësuesve të lartë të qeverisë lidhur me takimet e zhvilluara në kuadër të dialogut, duke përfshirë edhe takimin e fundit, ndërsa raportet e përditësuara të gjendjes së zbatimit të marrëveshjeve të dialogut duhet të hartohen sa më parë dhe të njëjtat të ndahen me Kuvendin dhe publikun", ka theksuar Haxholli.

# Krizë për pelet

**PRISHTINË, 23 GUSHT** - Besnik Hasani tash e dy javë është duke kërkuar pelet në tregun e Kosovës. Në shumë dyqane thotë se ka mungesë, ndërsa aty ku ka është shtrenjtë. “Nuk e di se si do t’ia dal dimrit”, thotë ky qytetar nga Fushë-Kosova, i cili shtëpinë e ngrohë me pelet. “Dimri mund të jetë i paparashikueshëm, temperaturat mund të jenë shumë të ulëta, rrymë po thonë se nuk ka, mund të mos kem as mjete financiare... veç unë punoj në familje”, thotë ai. Një ton i kësaj lënde djegëse vitin e kaluar ka kushtuar rreth 200 euro, sot kushton deri në 450.

Besniku, i cili punon në një agjenci turistike dhe paguhet 450 euro në muaj, thotë se vitin e kaluar ka blerë pesë tonë pelet me 900 euro. Në këtë dimër mbajtësi i familjes shtatanëtarëshe thotë se do t’i duhen mbi 2 000 euro për t’i plotësuar nevojat.

Krahas rritjes së çmimit, në treg vërehet edhe mungesë e peletit. Arsyet janë të ndryshme - nga rritja e kërkesës deri te reduktimi i prodhimit.

Qeveria e Kosovës tashmë u ka bërë thirrje qytetarëve që gjatë dimrit të gjejnë alternativa për ngrohje për shkak të situatës së

paqëndrueshme energjetike. Dhe këto alternativa janë ose peleti, ose drutë.

Nga qeveria, po ashtu, janë zotuar se do t’i identifikojnë fabrikat e shuara të peletit në Kosovë dhe se do t’i shqyrtojnë mundësitë për aktivizimin e tyre me qëllim të rritjes së prodhimit.

Në një deklaratë më 10 gusht, ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka thënë se shumë kompani për prodhimin e peletit kanë dalë nga tregu vitet e fundit, por nuk ka treguar numrin e tyre e as arsyt e shuarjes. REL-i e ka pyetur ministrinë që udhëheq ajo nëse ka identifikuar ndonjë kompani të shuar dhe cilat janë mundësitë e përkrahjes së tyre, por nuk ka marrë përgjigje.

REL-i ka biseduar me Xhevat Shalën, kompania e të cilit, “Eko-Pelet”, është mbyllur para pesë vjetësh. Ai thotë se hapësira e vogël për biznes dhe pamundësia për të investuar më shumë e kanë detyruar ta mbyllë kompaninë me bazë në Pejë. “Investimi ka qenë rreth 100 mijë euro. Hapësira e objektit ka qenë e vogël. Objekti është në oborr të shtëpisë. Kam kërkuar ndihmë financiare nga institucionet, por nuk më kanë ndihmuar. Kështu

që e kam mbyllur... Fabrika ekziston. Nëse më ndihmon shteti, unë mund ta aktivizoj”, thotë Shala.

## Mungesë e lëndës së parë

Bashkim Zejnullahu, pronar i kompanisë së peletit “Thes-Ari” në komunën e Vitisë, thotë se është duke prodhuar, por në sasi më të vogël. Sipas tij, problem është bërë sigurimi i lëndës së parë sepse, siç thotë, shumica e vendeve të rajonit e kanë pezulluar eksportimin e saj.

Zejnullahu thotë se, tash për tash, lëndën e parë e siguron nga Kroacia, por shton se kapacitetin e prodhimit do të duhet ta zvogëlojë nga rreth 15 mijë tonë, sa e ka pasur vitin e kaluar, në rreth 10 mijë. “Është gjendje kritike... Rajoni ka qenë furnizues i madh në tregun e Kosovës”, thotë ai.

Kriza energjetike është bërë globale për shkak të çrregullimeve në tregje që ka shkaktuar fillimisht pandemia e koronavirusit, pastaj edhe lufta e Rusisë në Ukrainë. Shumica e vendeve po përpiqen t’i kursejnë produktet për nevojat e veta. Zejnullahu thotë se kërkesa e konsumatorëve për pelet sivjet është shumëfish më e

lartë se në vitin e kaluar. Çmimi për klientët e tij thotë se është 350 euro për ton.

## Serbia dhe Bosnja ndaluan eksportin e peletit?

Zejnullahu thotë se disa shtete të rajonit, përveç që kanë ndaluar eksportin e lëndës së parë për pelet, kanë ndaluar edhe eksportin e peletit me të cilin janë furnizuar shumë kompani në Kosovë. Të njëjtën gjë e thotë edhe Shuajd Sopjani, menaxher në kompaninë e peletit “Aragonit”. Sipas tij, tregtarët në Kosovë janë furnizuar me pelet nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina, por i vetmi shtet nga i cili mund të bëhen furnizimet, tash për tash, është Mali i Zi. “Në Mal të Zi nuk mund ta marr sasinë e nevojshme, sepse çmimi është i lartë edhe për ne bizneset”, thotë ai, pa dhënë më shumë detaje.

Ministria e Tregtisë e Kosovës dhe Dogana e Kosovës nuk e kanë konfirmuar zyrtarisht ndalimin e importit të peletit nga Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina, edhe pse mediet në këto dy shtete kanë raportuar qysh në fillim të gushtit për ndalimin e eksportit. Sipas të dhënave

doganore, vlera e importit të këtij produkti në Kosovë gjatë vitit 2021 ka arritur në rreth 9 milionë euro.

Përveç te peleti, rritje e çmimit është regjistruar edhe te drutë dhe shumica e produkteve të tjera. Një metër kub dru në tregun e Kosovës aktualisht shitet deri në 70 euro, nga 40 euro sa ka kushtuar vitin e kaluar. Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës tregojnë se norma e inflacionit në muajin korrik ka arritur në 14 për qind, nga 0.9 për qind sa ka qenë në korrik të vitit të kaluar.

Në një situatë të tillë, shtuar këtu edhe reduktimet e rrymës që tashmë kanë nisur, autoritetet e Kosovës kanë paralajmëruar “dimër të vështirë”, por janë zotuar se do t’i subvencionojnë disa produkte për ngrohje. “Ekzekutivi do të subvencionojë pompat termike, stufat me pelet, ndërsa vëmendje e veçantë do t’u kushtohet familjeve që marrin ndihma sociale, duke subvencionuar edhe ngrohjen me dru zjarri”, ka thënë më 10 gusht ministrja e Ekonomisë, Rizvanolli. Diçka konkrete drejt materializimit të këtyre premtimeve nuk ka, ndonëse ende jemi në stinën e verës.



## 3 176 raste aktive me Covid në Kosovë

**PRISHTINË, 23 GUSHT** - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 977

testimeve, janë konfirmuar 274 raste të reje me Covid. Në këtë periudhë kohore nuk ka pasur

asnjë të vdekur nga ky virus. Në 24 orët e fundit janë shëruar 255 persona, kurse raste aktive

janë 3 176. Ndërkaq 55 persona janë vaksinuar kundër Covidit në 24 orët e fundit.



## Jasharaj, Nagavci: Greva nuk është kërcënim, nis më 25 gusht

PRISHTINË, 23 GUSHT - Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka thënë se greva e përgjithshme në arsim do të fillojë më 25 gusht ashtu siç ishte paralajmëruar. Duke iu përgjigjur deklaramëve të ministres së Arsimit, Arbërie Nagavci, se mësimi nuk mund të ndërpritet sa herë që dikush dëshiron, ai thotë se greva nuk është kërcënim. Madje ai ka paralajmëruar se ajo do të vazhdojë derisa qeveria ta bëjë realizimin e kërkesave të tyre. "Nuk është kërcënim. Ne gjithmonë kemi paralajmëruar dhe është e drejtë edhe me Ligjin për Greva. Pas një rrugëtimi kaq të gjatë kur qeveria nuk pranon dialog dhe nuk pranon të merret me kërkesat tona nuk kemi pasur zgjidhje tjetër përveç ta dëgjojmë zërin e anëtarësisë", ka thënë Jasharaj, duke shtuar se më 25 gusht nuk ka mësim. "Mësimdhënësit do ta bëjnë grevën në shkolla, çerdhet do të jenë në grevë dhe administrata do të jetë në grevë. Greva do të

zgjaset derisa qeveria të këndellet dhe të ketë qasje të drejtë ndaj kërkesave tona dhe t'i realizojë ato", ka thënë Jasharaj për "Ekonomia Online". Në ndërkohë, ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka thënë se MASHTI-i, në koordinim me komunat, i ka bërë përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor. Ministrja Nagavci ka thënë një ditë më parë se paralajmërimet e SBASHK-ut për ndërprerje të procesit mësimor kundrejt rritjes në paga nuk kanë arsytim. "Paralajmërimet e SBASHK-ut për ndërprerje të procesit mësimor kundrejt rritjes në paga nuk kanë arsytim. Ky cikël i përsëritshëm i kërcënimeve nuk mund të vazhdojë më. SBASHK-u gëzon të drejtë të garantuar ligjore për organizim dhe reagim sindikal, por nuk mund ta cenojë të drejtën kushtetuese të nxënësve për shkollim. Nuk ndërpritet procesi mësimor sa herë që dikush dëshiron", ka thënë Nagavci.



## Komunat dorëzuan paditë kundër MASHTI-t dhe MSh-së

Mbi 26 komuna përmes përfaqësuesve juridikë kanë dorëzuar të martën paditë ndaj Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) për kompensim të dëmit material të shkaktuar nga zbatimi i Kontratave Kolektive për arsim dhe shëndetësi

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 GUSHT - Komunat e Kosovës përmes përfaqësuesve juridikë kanë dorëzuar të martën paditë kundër Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) për kompensim të dëmit material të shkaktuar nga zbatimi i Kontratave Kolektive për arsim dhe shëndetësi. Komunat konsiderojnë se është



fakt i pakontestueshëm përgjegjësia e dy ministrive për të marrë obligim për kompensimin e dëmit ndaj komunave dhe qëllimi kryesor është që këto mjete t'u kthehen komunave. Vlerësohet që komunave u janë marrë mbi 35 milionë euro nga

buxhetet e tyre e për pasojë kemi mosrealizim të projekteve kapitale si dhe vlerësime jo të mira nga auditori në të kaluarën. Shumica e komunave përmes këtij procesi gjyqësor janë duke e shfrytëzuar të drejtën e tyre që mjetet financiare të cilat po u

merren komunave nga buxhetet e tyre të kompensohen nga këto dy ministri si nënshkruese të kontratës kolektive. Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahim, para gazetarëve ka thënë se qëllimi kryesor i

komunave është që këto mjete financiare të kthehen në buxhetet komunale. "Në mënyrë që këto mjete financiare të gjejnë zbatim në shumë projekte kapitale të cilat shkojnë në të mirën e qytetarëve", ka thënë Ibrahim, duke shtuar se mbi 26 komuna kanë dorëzuar padi.

## Shpërthen në flakë gjeneratori tek objekti i Ministrisë së Mjedisit

Prishtinë, 23 gusht - Tym i zi është ngritur në ajër të martën në Prishtinë, pasi një

gjenerator jashtë objektit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe

Infrastrukturës të Qeverisë së Kosovës është kapluar nga flakët. Zjarrfikësit kanë dalë

menjëherë në vendin e ngjarjes dhe e kanë shuar zjarrin.



## Banka Botërore: Kosova, inflacion 19.2 %

PRISHTINË, 23 GUSHT - Në indeksin mbi inflacionin e publikuar së fundi, Banka Botërore rendit Shqipërinë me inflacion 13.2 %, Kosovën me 19.2 %, Serbinë me 19.3 %, Maqedoninë e Veriut me 21.5 % dhe Malin e Zi me 23.1 %. Sipas BB-së, inflacioni i çmimeve të ushqimeve vendase mbetet i lartë në mbarë botën. “Nga prilli deri

në korrik 2022 inflacioni në produkte ushqimore është i lartë në pothuajse të gjitha vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Ndërkohë nga 11 gushti 2022 indeksi i çmimeve bujqësore është 1 % më i lartë se dy javë më parë. Krahasuar me mesataren e janarit 2021, indekset e çmimeve të misrit dhe grurit janë 20 % më të larta, ndërsa

indeksi i çmimit të orizit është 16 % më i ulët”, njofton BB. Sipas Bankës Botërore, lufta në Ukrainë ka ndryshuar modelet globale të tregtisë, prodhimit dhe konsumit të mallrave, duke ndikuar kështu që çmimet të jenë në nivele të larta deri në fund të vitit 2024, duke përkeqësuar pasigurinë ushqimore dhe inflacionin.



# Krasniqi: Qeveria ka bllokuar në tërësi investimet publike kapitale

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 GUSHT - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka thënë se qeveria Kurti ka hequr dorë nga çdo përpjekje serioze për ta ndihmuar vendin që ta përballojë krizën ekonomike me të cilën po ballafaqohet. Ai ka thënë se në vend të kësaj, qeveria më tepër duket e përcaktuar për një fushatë informuese me të cilën synon t'i njoftojë qytetarët se sa i rëndë do të jetë dimri që po vjen. “Të dhënat për muajin korrik tregojnë se çmimet e ushqimit në Kosovë kanë qenë për 22.1 % më të larta në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, përderisa të ardhurat e qytetarëve kanë mbetur të njëjta me periudhën e para krizës e që në terma realë, nënkupton një rënie të konsiderueshme të fuqisë

blerëse. Në tërë këtë situatë, Qeveria e Kosovës ka shfaqur vendosmëri të lartë për ta refuzuar çdo rekomandim që do të ndikonte në frenimin e rritjes së çmimeve, por edhe rekomandimet për rritjen e pagave, të pensioneve dhe të përfitimeve nga skemat sociale, për aq sa është niveli i inflacionit”, ka shkruar Krasniqi në “Facebook”.

Ai ka theksuar se në këtë mënyrë qeveria ka zgjedhur abstenimin karshi krizës më të rëndë që e ka kapluar vendin, me potencial të madh për ta rënduar edhe më tutje gjendjen e vështirë socio-ekonomike që po mbizotëron në Kosovë. “Në kohën kur të gjithë kishin sytë kah rritja e çmimeve, qytetarëve të Kosovës iu prezantua edhe një sfidë e re - ajo e reduktimit të energjisë elektrike në mes të verës. Dështimi për ta furnizuar vendin me energji elektrike, madje edhe gjatë kësaj



periudhe, paraqet paralajmërimin më të përafërt lidhur me atë se çka mund të presim për muajt që pasojnë, sidomos në stinën e dimrit”, është shprehur Krasniqi.

Ai ka shtuar se dështimi i qeverisë gjatë vitit të kaluar për të siguruar furnizim të mjaftueshëm me energji elektrike, me kushte më të favorshme, duket se nuk ka sjellë ndonjë mësim për institucionet as për këtë vit. “Madje as për t'i bërë përgatitjet e nevojshme për funksionim të plotë të kapaciteteve vendore të prodhimit të energjisë elektrike. Të gjitha këto zhvillime ndikojnë negativisht mbi konsumin, prodhimin dhe investimet në ekonominë e vendit, të cilat më tutje shtrijnë ndikim negativ në shkallën e punësimit dhe në të ardhurat e qytetarëve”, ka

deklaruar lideri i PDK-së. Krasniqi ka thënë se sikur të mos mjaftonin këto goditje për ekonominë, pikërisht gjatë këtij viti, Qeveria e Kosovës ka bllokuar pothuajse në tërësi investimet publike kapitale. “Shkalla e realizimit të investimeve publike kapitale deri në muajin qershor paraqet vetëm 11 % të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2022 për këtë kategori. Me këtë, ekonomisë së vendit po i mohohet një burim shumë i rëndësishëm i gjenerimit të aktivitetit ekonomik, përderisa vlera reale e depozitave të grumbulluara nga qeveria çdo ditë e më tepër po bie si rezultat i inflacionit dhe rritjes së vazhdueshme të çmimeve”, ka pohuar Krasniqi.

Ai ka thënë se si pasojë e këtyre kushteve, parashikimet e fundit

lidhur me rritjen ekonomike në Kosovë për vitin 2022 sugjerojnë një normë të rritjes prej vetëm rreth 2.5 %. “Por, me këtë mendësi qeverisëse, me këtë paaftësi e neglizhencë të frikshme, vazhdimi i kushteve aktuale ka gjasa të mëdha që ta shpie ekonominë e vendit tonë në një cikël të rënies apo recesionit, i cili, duke qenë i shoqëruar me këtë normë të lartë të inflacionit, paraqet një skenar ogurzi për ekonominë e vendit dhe për mirëqenien e qytetarëve. Në gjithë këtë situatë të rënduar, qeveria, përveç se është e humbur, po abstenon nga përgjegjësia që ka, ndërsa familjet e Kosovës kanë mbetur të vetmuara, pa asnjë mbështetje nga shteti i tyre, duke pritur ballafaqimin e vështirë me dimrin e rëndë që po vjen”, ka thënë Krasniqi.



## LDK-ja propozon dhjetë pika për ta përballuar krizën e energjisë elektrike

PRISHTINË, 23 GUSHT - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka mbajtur të martën konferencë për medie. Deputetët Hykmete Bajrami dhe Besian Mustafa kanë shpalosur planin prej dhjetë pikësh që do të ketë efekte të menjëhershme dhe afatgjatë në uljen e shpenzimeve për qytetarët dhe kompanitë, si dhe për stabilitetin afatgjatë të furnizimit me energji për vendin tonë. “1. Pagesa e

menjëhershme e subvencioneve të premtuara prej 90 milionë eurosh për çmimin e energjisë elektrike; 2. Riparimi i Bllokut A5 i Termocentralit Kosova A; 3. Krijimi i mekanizmave për furnizim me burime alternative për ngrohje me çmime të përballueshme për qytetarët; 4. Përgatitja e planit të eficiencës dhe kursimit të energjisë; 5. Negocimi i kontratave afatgjatë për furnizim me energji; 6.

Zbritja e TVSh-së nga 8 % në 0% për faturat e energjisë; 7. Krijimi i subvencioneve të reja për qytetarët dhe bizneset; 8. Largimi i tarifave diskriminuese të ZRrE-së; 9. Themelimi i bursës së përbashkët për energji Kosovë - Shqipëri; dhe 10. Përgatitja e Strategjisë afatmesme për rritjen e kapaciteteve gjeneruese me gaz dhe energji alternative”, është bërë me dije nga deputetët e LDK-së.





# Ja si flota ruse e bllokoi Adriatikun



**Nga Gianluca DI FEO**  
"La Repubblica"

Është një sfidë e fshehtë, dhe ndonjëherë tejet e pamatur. Flota ruse dhe ajo e NATO-s përballen me njëra-tjetrën në Mesdhe, duke qenë shpeshherë në distanca shumë të afërta me njëra-tjetrën. Vetëm 3 javë më parë, anijet e Moskës kryen një operacion shumë të guximshëm. Ato u pozicionuan për të bllokuar Detin Adriatik, me synim pengimin e lëvizjes së aeroplanmbajtëses amerikane "Truman".

Një lëvizje shumë strategjike, pasi ky është deti më afër fushëbetëve të Ukrainës, dhe nga i cili raketat dhe aeroplanët mund të ndërhyjnë teorikisht më shpejt në vijën e parë të frontit.

Më 22 korrik, anija luftëtare "Amiraliati Tributs" kaloi kanalën e Otrantos dhe u ngjit më në veri. Ai u zhvendos nga Gargano dhe u vendos para brigjeve të Abruzzo, të tejpulluaranga njerëzit për shkak të pushimeve verore. Por nuk ishte vetëm. Nga pas e ndiqte kryqëzorin "Varyag", me bateritë e tij të raketave me reze të gjatë veprimi.

Ky i dyti qëndroi përballë qytetit-port italian të Salentos, duke mbajtur nën vëzhgim rrugë-kalimin kyç për në Adriatik. Së bashku me të ishte edhe një luftanije e tretë, "VasilyTatishchev", e specializuar në spiunazh, dhe e

pajisur me instrumente për të përgjuar komunikimet radio dhe impulset e sensorëve. Detyra e tij ishte të studionte "reagimet elektronike" të NATO-s ndaj këtij inkursioni provokues.

## Për herë të parë në Adriatik

Që nga fillimi i luftës në Ukrainë, flota ruse nuk kishte hyrë kurrë në Detin Adriatik. Disa herë anijet e Moskës kishin ardhur për të monitoruar nga afër stërvitjet e Aleancës Atlantike, duke arritur deri në ujërat e Kalabrisë, në jugun e Italisë. Por nuk kishin guxuar asnjëherë të kryenin një "manovër bllokuese", që synoi të kufizonte lëvizjet e aeroplanmbajtëses amerikane "Truman", mjeti kryesor i dislokimit të NATO-s në Detin Mesdhe, që muajt e fundit udhëton shpesh përgjatë një rruge nga Sicilia në Adriatik dhe anasjelltas.

Operacioni i Marinës Ruse, shkaktoi fillimin e një duel të gjatë në heshtje, ku komandat e NATO-s u angazhuan t'u tregojnë rusëve nuk do të hiqnin dorë nga kontrolli i kalimit midis deteve Jon dhe Adriatik. Kështu, në ditët e fundit të korrikut, kryqëzori "Varyag" u gjend më pak se 100 kilometra larg homologut amerikan "Forrest Sherman".

Ato ishin praktikisht në të dy anët e kepit të Santa Maria di Leuca. Rusët në anën e

Adriatikut, dhe amerikanët në anën e Jonit. Pak më në jug, aeroplanmbajtësja "Truman", me afro 60 avionë gjuajtës-bombardues F18 Hornet në bord, dhe me një eskortë të marinës amerikane.

Mes tyre ishte një ekip i NATO-s – Grupi i Dytë Detar i Përhershëm – me anije luftarake dhe fregata amerikane, italiane, spanjolle, turke dhe greke, të cilat më 25 korrik u mblodhën në Detin Jon për të formuar një kuadrat rreth aeroplanmbajtëses "Truman".

## Operacioni rus midis Puljas dhe Siçilisë

Operacioni rus u zbulua nga faqja "The Ship Yard Naval Consultancy", e cila analizon informacionet nga satelitët komercialë, dhe është konfirmuar për "La Repubblica" nga burime zyrtare. Por misionet e disa gjurmuesve – të përshkruara nga portali Itamilradar – kishin treguar se diçka po ndodhte mes Siçilisë dhe Puljas.

Sidomos më 31 korrik, një nga dronët-spiunë më të mëdhenj që ka SHBA, GlobalHaëk, qënisset çdo ditë nga Sigonella për të shkuar në Detin e Zi dhe për të monitoruar konfliktin ukrainas, patrolloi një pjesë të Detin Jon për orë të tëra, duke vazhduar fluturimin mbi një zonë specifike. E njëjta ku për 3 ditë rresht ishin përqendruar patrullimet e avionëve italianë P72.

## Kryqësori "Varyag"

Nuk dihet se cili është pozicioni aktual i anijeve ruse, dhe nëse aktiviteti i tyre shoqërohej edhe nga një nëndetëse. Megjithatë, 3 ditë më parë avionët italianë të zbulimit, kanë rinisur tëpatullojnë më intensivisht ujërat mes Kalabrisë dhe Greçisë, duke u fokusuar në disa zona.

Pasi dyshohet se të paktën një nga mjetet e marinës ruse ndodhet ende në zonë. Kryqësori "Varyag" është binjaku i "Moskva", që u fundos nga ukrainasit më 14 prill. Ajo është një nga anijet më të fuqishme në flotën e Putinit, me 16 raketa P-1000 Vulcan me reze të gjatë veprimi në bord, që janë dizenuara të shkatërrojnë aeroplanmbajtëset amerikane.

Sipas propagandës ruse, ato e bëjnë këtë duke vepruar së bashku "si një tufë ujçerësh që sulmon gjahun e saj". Ato mund të godasin nga 500 kilometra larg, duke udhëtuar me njëshpejtësi 3 herë më të madhe se ajo e zërit. Krahasuar me "Moskva", "Varyag" ka njëmbrojtje kundërajrore dhe radarë më të avancuar.

## Admiraliati Tributs

Ndërkohë, "Admiraliati Tributs" është një luftanije e shkëlqyer për luftën kundër nëndetëseve, e pajisur gjithashtu me raketa të projektara për të rrëzuar raketat lundruese amerikane. Dy anijet të ndërhuara në vitet e

fundit të Bashkimit Sovjetik, dhe që i janë nënshtruar disa herë modernizimit, janë një çift i përhershëm në flotën e Paqësorit.

Ato u nisën dhjetorin e vitit të kaluar nga baza e tyre në Vladivostok, porti përballë Japonisë, kaluan oqeanet dhe zbarkuan në Mesdhe, për të forcuar pozicionet mbrojtëse në funksion të pushtimit të Ukrainës. Që nga ajo kohë ato janë kanë formuar "majën e sulmit" rus që lëviz nga Siria në Perëndim për të ndjekur Aleancën Atlantike, duke u alternuar me ekipin tjetër të formuar nga kryqësori "Slava", një luftanije, dy fregata dhe një korvetë.

Së fundi, të paktën 2 nëndetëse të klasit "Kilo" – që nuk bëjnë zhurmë dhe të armatosura me raketa Kalibr – po kryejnë ekspedita pranë Bosforit. Këto duele janë deti tani të kufizuara në manovra, pak a shumë agresive, dhe në shkëmbime të impulseve të radarit, për të treguar aftësinë e goditjes së kundërshtarit.

Lojëra luftarake, që me kalimin e muajve po bëhen gjithnjë e më të shpeshta dhe më të rrezikshme. Pak ditë më parë, një dokument strategjik nga Kremli, përsëriti rëndësinë qëkanë rrugët detare të Mesdheut Lindor për "interesin kombëtar" të Rusisë. Ky synim i nxit admiralët e Putinit të nisin një Luftë të re të Ftohtë, me nivele tensioni gjithnjë e më të larta, dhe që vërehen gjithnjë e më shpesh në detet italiane.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enverti  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Rama: I nderuar me vizitën e yllit të boksit, Florian Marku

**TIRANË, 23 GUSHT** - Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, e priti të martën në ambientet e kryeministrit, boksierin me famë botërore, Florian Marku, i cili do të përballet më 25 gusht në një duel me Miguel Parra Ramirez. Kjo përballje do të zhvillohet në stadiumin "Air Albania". Nëpërmjet një postimi në "Facebook", Rama është shprehur i nderuar nga vizita e një tjetër ylli të sportit shqiptar, superstarit të ringut Florian Marku. Gjatë vizitës, Marku i dhuroi kryeministrit një palë

doreza boksi, të cilat kryeministri nuk ngurroi t'i vishte dhe të bënte foto me yllin shqiptar. "I nderuar nga vizita e një tjetër ylli të sportit shqiptar, superstarit të ringut Florian Marku, që të enjten, më 25 gusht, synon në 'Air Albania Arena' gjerdanin e madh të kampionit të kategorisë sipërore WBC, në një ndeshje për historinë e boksit botëror", ka shkruar Rama. Më herët kryeministri priti kampionen e Evropës, Luiza Gega, së cilës i dorëzoi Kordonin me Yllin për Mirënjohje publike.



## Ismajli, pjesë e formacionit të javës në Serinë A

**EMPOLI, 23 GUSHT** - Portali i njohur i futbollit "Goal.com" e ka publikuar formacionin e javës në kampionatin italian. Pjesë e formacionit për javën e dytë është edhe një futbollist shqiptar. Bëhet fjalë për qendërmbrojtësin nga Kosova, Ardian Ismajli, i cili ka bërë paraqitje superiore për Empolin, duke ia mohuar golin Fiorentinës në fundjavë, në ndeshjen që përfundoi me rezultat 0-0. "Empoli arriti ta përballojë sulmin total të Fiorentinës edhe falë murit të ngritur nga mbrojtja e tij. Në mesin e të shumtëve bie në sy performanca e Ismajlit, i cili i lejoi shumë pak hapësira Joviçit dhe më pas e mbajti peshën kryesore të repartit kur bashkëlojtari i tij, Luperto, u përjashtua me karton të kuq në minutën e 66. Në 99 minuta lojë, shqiptari ishte providencial, edhe kur largoi një goditje nga Duncan nga porta e pambrojtur", e ka përshkruar "Goal.com" paraqitjen e përfaqësuesit shqiptar. Formacioni (4-2-3-1): Silvestri, Ismajli, Smailling, Kim, Dimarco, Bennacer, Anguissa, Berardi, Malinovskyi, Kvaratskhelia, Lautaro.



## Sot hidhet shorti për edicionin e ri në basketboll

**PRISHTINË, 23 GUSHT** - Sot (e mërkurë) në zyrat e Federatës së Basketbollit të Kosovës do të hidhet shorti për edicionin e ri të Superligës së basketbollit në dy konkurrencat dhe në ligat e tjera. Shorti për edicionin Prince Caffè Superliga për meshkuj do të fillojë nga ora 13:00, i cili mund të përcillet edhe

drejtpërdrejt në faqen zyrtare të "Facebook"-ut "Kosovo Basketball Federation", kurse shorti për Superligën e femrave nga ora 12:00. Në orën 11:00 tërhiqet shorti për Ligën e Parë të meshkujt, ndërsa në orën 14:30 shorti për Ligën e Parë të femrat. Nga ora 15:30 tërhiqet shorti për Ligën e Dytë.



## Gjimshiti mungon dy muaj

**BERGAMO, 23 GUSHT** - Berat Gjimshiti është lënduar në ndeshjen kundër Milanit pas një përplasjeje që ka pasur me sulmuesin Oriqi. Qendërmbrojtësi shqiptar iu nënshtrua ekzaminimeve mjekësore që zbuluan një frakturë në një nga kockat e

kërcirrit të majtë të Gjimshiti me këtë të fundit që parashikohet të qëndrojë jashtë fushave të lojës për dy muaj që do të thotë se, nëse konfirmohet kjo prognozë, Gjimshiti do të kthehet në fushat e lojës në fund të muajit tetor. Gjimshiti me shumë gjasë do të

humbasë dy ndeshjet e kombëtares kuqezi për Ligën e Kombeve ndaj Islandës dhe Izraelit që do të luhen më 24 dhe 27 shtator. Ndërsa në Serinë A do të mungojë në nëntë sfida mes të cilave ato me Romën, Fiorentinën dhe Lazion.



## Zbulohet lista e të ftuarve të Kosova U20 për ndeshjet e Kampionatit Ballkanik

PRISHTINË, 23 GUSHT - Trajneri Blendi Haxhikadrija, së bashku me stafin, kanë vendosur për listën përfundimtare të të ftuarve për Kampionatin Ballkanik U20, i cili do të zhvillohet mes datave 6-10 shtator në Shqipëri.

Përgjatë dy ditëve të fundjavës, në grumbullimet seleksionuese morën pjesë një numër i kënaqshëm i lojtarëve, të cilët iu nënshtruan testeve fizike dhe parametrave antropometrikë. Kontingjenti i volejbollistëve të

përzgjedhur gjatë kësaj jave do t'i vazhdojë përgatitjet në Gjakovë, ku do të stërviten intensivisht para udhëtimit në Shqipëri. Grumbullimi i parë mbahet sot (e mërkurë) nga ora 12:00. Lista e plotë: Albi Macula, Eron

Murseli, Erion Bajrami, Adonis Hyseni, Enes Shabani, Endrit Sylja, Ervin Llazicani, Rinor Hazrolli, Erolind Kerqeli, Enes Haxha, Elis Taha, Erald Boshnjaku, Endi Zejna, Yll Salihu.



## Zbulohet lista e të ftuarve të Kosova U20 për ndeshjet e Kampionatit Ballkanik



Prishtinë, 23 gusht - Trajneri Blendi Haxhikadrija, së bashku me stafin, kanë vendosur për listën përfundimtare të të ftuarve për Kampionatin Ballkanik U20, i cili do të zhvillohet mes datave 6-10 shtator në Shqipëri. Përgjatë dy ditëve të fundjavës, në grumbullimet seleksionuese

morën pjesë një numër i kënaqshëm i lojtarëve, të cilët iu nënshtruan testeve fizike dhe parametrave antropometrikë. Kontingjenti i volejbollistëve të përzgjedhur gjatë kësaj jave do t'i vazhdojë përgatitjet në Gjakovë, ku do të stërviten intensivisht para udhëtimit në Shqipëri.

Grumbullimi i parë mbahet sot (e mërkurë) nga ora 12:00. Lista e plotë: Albi Macula, Eron Murseli, Erion Bajrami, Adonis Hyseni, Enes Shabani, Endrit Sylja, Ervin Llazicani, Rinor Hazrolli, Erolind Kerqeli, Enes Haxha, Elis Taha, Erald Boshnjaku, Endi Zejna, Yll Salihu.

### SHKURT

#### Cikalleshi transferohet në Arabinë Saudite

Sokol Cikalleshi është larguar nga Konyaspori pas dy vjetëve qëndrim te ky klub. Sulmuesi i kombëtares ka vendosur të provojë një aventurë në Arabinë Saudite aty ku do ta vijojë karrierën te klubi i Al Khaleej. Në fakt, Cikalleshi mbetet në pronësinë e klubit turk Konyaspor, mirëpo do të kalojë në klubin arab vetëm me anë të formulës së huazimit e cila do të ketë një kohëzgjatje prej një viti. Në sezonin e kaluar, Khaleej u shpall kampion në Arabi dhe me Cikalleshin kërkon ta shtojë edhe më shumë forcën në repartin ofensivë. Në sezonin e kaluar sulmuesi i kuqezinjve ia doli të shënonte 10 gola si dhe dy asistime me fanellën e Konyasporit. Cikalleshi ka kontratë me Konyan deri në verën e vitit 2024, ndërsa huazimi i tij te klubi arab do të jetë i thjeshtë pa formulë blerje përfundimtare.

#### Zverevi tërhiqet nga US Open

Tenisti gjerman Alexander Zverev, numri dy në botë për meshkuj, ka konfirmuar mungesën e tij në grand slam e US Open, që nis më 29 gusht në Nju-Jork. Ai u dëmtua gjatë gjysmëfinaleve të Roland Garros, ku doli nga fusha me paterica. Edhe pse gjermani u operua dhe nisi gradualisht stërvitjen, ai ende nuk është gati të luajë. Madje ende nuk ka një datë të saktë se kur Zverevi do të rikthehet të luajë, duke rrezikuar ta humbasë pozicionin në renditje. Lajmin e mungesës së tenistit gjerman e konfirmuan edhe organizatorët e US Open, që nuk e kanë përfshirë Zverevin në listën e tenistëve pjesëmarrës. "Nuk jam ende gati dhe nuk dua ta rrezikoj karrierën time me një rikthim të parakohshëm", ka thënë Zverevi.

#### Vetëm 240 sekonda kundër Liverpoolit, Ronaldo jashtë projektit të Unitedit

Manchester Unitedi e fitoi derbin ndaj Liverpoolit, por jo të gjithë janë të lumtur. Ajo që bëri përshtypje në përballjen me të kuqtë ishte lënia në stol e Maguires dhe Ronaldos, një zgjedhje e guximshme e Ten Hagut pasi bëhej fjalë për kapitenin dhe për një lojtar si Ronaldo. Tekniku holandez i rezervoi Ronaldos vetëm 240 sekonda, një detaj që vërteton edhe një herë se sulmuesi portugez nuk bën pjesë në planet e tij. Ronaldo, por tashmë edhe drejtuesit e klubit apo trajneri Erik Ten Hag, shpresojnë shumë që portugezi të largohet brenda datës 31 gusht, periudhë kjo kur përfundon merkatoja e transferimeve.

#### Cavani, afër kalimit të Valencia

Edinson Cavani është shumë pranë transferimit te skuadra e Valencias. Sipas asaj që raporton "RMC Sport", sulmuesi uruguaiian ka arritur marrëveshjen me skuadrën që drejtohet nga Gattuso. 35-vjeçari ndodhet pa klub pas përfundimit të bashkëpunimit me Manchester Unitedin dhe për klubin e La Ligës do të jetë një transferim me peshë duke parë karakteristikat e vet "El Matador"-it. Përveç "djave të kuq", uruguaiiani, gjithashtu, ka mbajtur veshur edhe fanellat e PSG-së, Napolit, Palermos dhe Manchester Unitedit. Në sezonin e kaluar Cavani u aktivizua gjithsej në 15 ndeshje, ku arriti të shënonte dy gola dhe të dhuronte edhe një asistim.

## Shtyhet fillimi i Kupës së Botës në Katar

DOHA, 23 GUSHT - Presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, së bashku me presidentët e gjashtë konfederatave, kanë votuar për shtyrjen e Kampionatit Botëror "Qatar 2022". Kupa e Botës ishte paraparë të fillonte më 21 nëntor dhe të zgjaste deri më 18 dhjetor, por ajo do të fillojë një ditë më herët, më 20 nëntor. Katari fitoi organizimin e Botërorit 12 vjet më parë dhe që atëherë dihej se ndeshja e xhiros së parë në të cilën do të luajë Katari do të caktohet në ditën e parë të turneut. Mirëpo, sipas orarit fillestar, Senegali dhe Holanda duhej ta hapnin kampionatin më 21 nëntor në orën 14:00 dhe Katari dhe Ekuador do të luanin më vonë atë ditë në orën 20:00. Në vend që thjesht t'i ndërronte datat e dy ndeshjeve, FIFA vendosi të shtyjë për një ditë fillimin e kampionatit. Kështu Katari dhe Ekuadori do ta



hapin Botërorin më 20 nëntor në orën 17:00 dhe një ditë më pas do të luhen ndeshjet e planifikuara për 21 nëntor: Senegal - Holandë në orën 14:00, Angli - Iran në orën 17:00 dhe ShBA - Uells në orën 20:00. Më të prekurit nga ky vendim

janë tifozët që vijnë nga Ekuadori i largët, të cilët tashmë kanë prenotuar fluturimet dhe akomodimin në Katar, duke planifikuar që ndeshja e tyre e parë të jetë e planifikuar për në 21 nëntor.

## Kloppi, pas humbjes nga Unitedi: Ishte mbrëmja e De Geas

Liverpooli ka mbetur pa fitore edhe pas javës së tretë në Premierë Ligë, derisa mbrëmë është mposhtur nga Manchester Unitedi (2-1). Trajneri gjerman Jurgen Klopp

ka thënë se ishte i kënaqur me skuadrën e tij dhe mënyrën si e interpretoi lojën, teksa theksoi se me pak fat në finalizim, do të mund të diskutonin për një rezultat

tjetër. "Ata ishin shumë agresivë që në fillim dhe e kuptova që do të ishte një ndeshje e vështirë. Pas golit të Sanchos morëm kontrollin e lojës, por nuk arritëm të shënojmë, për

të shkuar në dhomat e zhveshjes me barazim. Në pjesën e dytë goli i Rashfordit na prishi planet, megjithatë kuptova që kur skuadra luan e qetë. Është vërtetë e

rrezikshme. Krijua shumë raste dhe ishim pa fat, ndërsa De Gea tregoi se ishte në mbrëmjen e tij. Pa ato pritje, do të diskutonim për një tjetër rezultat", ka deklaruar Kloppi.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553  
PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Agron Kadriu shpall të pavlefshme dy dëftesat shmlt "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Dreni Spahiu shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Palush Dedaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Lidhja e Prizrenit" Prizren.
- ▶ Shemsije Emraj shpall të pavlefshme certifikatën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Kastriot Ninaj shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Asad Jusufi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Nefit Jusufi" Skorobisht.
- ▶ Merita Mulaj shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Ali Sokoli" Prishtinë.
- ▶ Alban Gunga nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. "Mustafa Bakija" Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.
- ▶ Leonora Kulludra nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari".
- ▶ Ardian Nikollbibaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë, drejtimi teknik i Elektroteknikes.
- ▶ Taulant Ermeni nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII, XIII dhe diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari"
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



### KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 03.06.2022 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 24.08.2022 të rishpallë:

#### KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendeve të punës:

**Një (1) Punëtor Fizik** -Njësia në Skënderaj me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi

#### Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor;
- Zbrazen e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjerë në deponi;
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve;
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit;
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve;
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngjajshme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtëpërdrejtë.

#### Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë diplomën e shkollës fillore ose të mesme;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

#### Kushtet e veçanta:

Punëtori gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 24.08.2022 deri më datën 07.09.2022. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



### KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 03.06.2022 për shpalljen e konkursit , gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M. "Uniteti" Sh.A vendosi që me datë 24.08.2022 të rishpallë:

#### KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendeve të punës:

**Një (1) Vozitës të kategorisë "C"**- Njësia në Skenderaj me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sipas Urdhërësës së Punës drejton automjetin dhe kujdeset për rregullësin, higjienën dhe pastërtin e tij,
- Është përgjegjës për vozitje të sigurt dhe për kryerjen me kohë, efikase dhe kualitative të shërbimeve në bartjen e mbeturinave, larjen e rrugëve etj.
- Në rastet kur e kryen terrenin e caktuar angazhohet në pika (zona), tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit-kryepunëtorit,
- Para daljes në teren merr Urdhërësën e Punës në të cilën evidencen punët e kryera , vërejtjet mbi pengesat dhe defektet në automjet, dhe të njejtën e kthen te dispeçeri,
- Vendosi (monton) letren e re të tahografit ndërsa letren paraprake e kthen te dispeçeri, brenda 12 orëve,
- Vozitësi i cili e monton letren e tahografit ka obligim që në të shënon: Emrin e tij, numrin e regjistrimit të automjetit, datën dhe kilometrazhën fillestare dhe përfundimtare,
- Është i obliguar që në automjet të ketë mjetet e nevojshme të punës (lopatat, fshisat etj.), për ekipën e punëtorëve me të cilët punon, largon (bartë) shtazët e ngordhura dhe i evidenton në urdhëresen e punës.
- Në rast nevojë ndrron gomat e automjetit në teren, apo në punëtorinë e mirëmbajtjes në bashkëpunim me gomisterin,
- Është i obliguar që prishjet në automjet me kohë t'i lajmon me shkrim te udhëheqësi i drejtëpërdrejtë dhe në punëtorinë e mirëmbajtjes
- Çdo sjellje të pandërgjegjshme të punëtorëve me të cilët punon vozitësi është i obliguar që ta paraqet te udhëheqësi i drejtëpërdrejtë
- Kryepunëtori e njofton kryepunëtorin për kontejnerët e dëmtuar dhe sipas kërkesës së tij, bënë bartjen e tyre në punëtorinë e mirëmbajtjes për riparim,
- Është i obliguar që në Deponi të mbeturinave tu përmbahet rregullave dhe obligimeve të parapara në lidhje me procesin e punës në Deponi,
- Nëse automjeti me të cilin punon ndodhet në prishje apo jashtë planit momental për përdorim, është i obliguar që të drejton automjetin tjetër , dhe të kryen punë tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit, të drejtëpërdrejtë nevojës së procesit të punës dhe interesit të ndërmarrjes.

#### Kualifikimet

- Të ketë diplomën e shkollës mesme
- Vozitës i kategorisë "C"
- Të prezantoj leternjoftimin
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

#### Kushtet e veçanta:

Punëtori 6 (gjashtë) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat, etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15)ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 24.08.2022 deri më datën 07.09.2022. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



### KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 03.06.2022 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 24.08.2022 të rishpallë:

#### KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendeve të punës:

**Tre (3) Punëtor Fizik** -Njësia në Vushtrri me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi

#### Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor;
- Zbrazen e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjerë në deponi;
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve;
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit;
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve;
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngjajshme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtëpërdrejtë.

#### Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë diplomën e shkollës fillore ose të mesme;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

#### Kushtet e veçanta:

Punëtori gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15)ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 24.08.2022 deri më datën 07.09.2022. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



### KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 03.06.2022 për shpalljen e konkursit , gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M. "Uniteti" Sh.A vendosi që me datë 24.08.2022 të rishpallë:

#### KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendeve të punës:

**Një (1) Vozitës të kategorisë "C"**- Njësia në Vushtrri me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sipas Urdhërësës së Punës drejton automjetin dhe kujdeset për rregullësin, higjienën dhe pastërtin e tij,
- Është përgjegjës për vozitje të sigurt dhe për kryerjen me kohë, efikase dhe kualitative të shërbimeve në bartjen e mbeturinave, larjen e rrugëve etj.
- Në rastet kur e kryen terrenin e caktuar angazhohet në pika (zona), tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit-kryepunëtorit,
- Para daljes në teren merr Urdhërësën e Punës në të cilën evidencen punët e kryera , vërejtjet mbi pengesat dhe defektet në automjet, dhe të njejtën e kthen te dispeçeri,
- Vendosi (monton) letren e re të tahografit ndërsa letren paraprake e kthen te dispeçeri, brenda 12 orëve,
- Vozitësi i cili e monton letren e tahografit ka obligim që në të shënon: Emrin e tij, numrin e regjistrimit të automjetit, datën dhe kilometrazhën fillestare dhe përfundimtare,
- Është i obliguar që në automjet të ketë mjetet e nevojshme të punës (lopatat, fshisat etj.), për ekipën e punëtorëve me të cilët punon, largon (bartë) shtazët e ngordhura dhe i evidenton në urdhëresen e punës.
- Në rast nevojë ndrron gomat e automjetit në teren, apo në punëtorinë e mirëmbajtjes në bashkëpunim me gomisterin,
- Është i obliguar që prishjet në automjet me kohë t'i lajmon me shkrim te udhëheqësi i drejtëpërdrejtë dhe në punëtorinë e mirëmbajtjes
- Çdo sjellje të pandërgjegjshme të punëtorëve me të cilët punon vozitësi është i obliguar që ta paraqet te udhëheqësi i drejtëpërdrejtë
- Kryepunëtori e njofton kryepunëtorin për kontejnerët e dëmtuar dhe sipas kërkesës së tij, bënë bartjen e tyre në punëtorinë e mirëmbajtjes për riparim,
- Është i obliguar që në Deponi të mbeturinave tu përmbahet rregullave dhe obligimeve të parapara në lidhje me procesin e punës në Deponi,
- Nëse automjeti me të cilin punon ndodhet në prishje apo jashtë planit momental për përdorim, është i obliguar që të drejton automjetin tjetër , dhe të kryen punë tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit, të drejtëpërdrejtë nevojës së procesit të punës dhe interesit të ndërmarrjes.

#### Kualifikimet

- Të ketë diplomën e shkollës mesme
- Vozitës i kategorisë "C"
- Të prezantoj leternjoftimin
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

#### Kushtet e veçanta:

Punëtori 6 (gjashtë) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat, etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15)ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 24.08.2022 deri më datën 07.09.2022. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

